



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDIK

Nr. DMN – 020 – 2016

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

Presidenti i Republikës së Kosovës,  
në mbështetje të nenit 18 (paragrafët 2 dhe 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,  
nenit 10 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare Nr. 28, 16 dhjetor 2011), nenit 4 (paragrafi 3) të Ligjit Nr. 03/L-044, për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik (Gazeta Zyrtare Nr. 26, 02 qershor 2008) si dhe nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), nxjerr këtë:

**DEKRET**

1. Ratifikohet Marrëveshja për ndryshimin e Marrëveshjes për transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, e datës 27 qershor 2011, e nënshkruar në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, më 9 shtator 2016 dhe e pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës më 15 shtator 2016.
2. Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
3. Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.
4. Ky Dekret hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 28.09.2016.

## Shtojca II

# MARRËVESHJE PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE. E NËNSHKRUAR MË 27 QERSHOR 2011

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë janë dakorduar për ndryshimet në vijim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave:

### Neni 1

Paragrafi 1 i nenit 1 ndryshohet si në vijim:

"1. Kjo marrëveshje zbatohet për transportin rrugor të mallrave dhe udhëtarëve për në, nga dhe në transit nëpër territoret e Palëve Kontraktuese, si dhe transportin rrugor për në nga vendet e treta, i kryer nga operatorët e transportit të themeluar në territorin e njërit nga Palët Kontraktuese, me anë të automjeteve, siç përcaktohet në nenin 2 të kësaj marrëveshje."

### Neni 2

Paragrafi 1 i nenit 2 ndryshohet si në vijim:

"1. 'Operator i transportit' nënkupton një person (përfshirë personin juridik), i cili është themeluar në territorin e njërit nga Palët Kontraktuese dhe është pranuar ligjërisht në vendin e themelimit, i cili transporton udhëtarë dhe mallra kundrejt një pagese apo për nevojat e veta, në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar që rregullon qasjen në profesionin e operatorit të transportit dhe në treg."

Paragrafi 2 i nenit 2 ndryshohet si në vijim:

"2. 'Automjet' nënkupton mjetin motorik të vetëm apo në kombinim me automjete, rimorkio apo gjysmë rimorkio, i destinuar për transportin rrugor të udhëtarëve apo mallrave, në dispozicion të operatorit të transportit, qoftë në pronësi të tij ose në shfrytëzim me pagesë ose qira."

Paragrafi 3 i nenit 2 ndryshohet si në vijim:

"3. 'Regjistrim' nënkupton autorizimin administrativ për automjetet që të marrin pjesë në komunikacionin rrugor, duke përfshirë identifikimin e këtyre të fundit dhe lëshimin e numrit të targave të regjistrimit."

Paragrafi 5 i nenit 2 ndryshohet si në vijim:

"5. 'Kabotazh' nënkupton operimet e transportit të mallrave dhe udhëtarëve që kryhen nga një operator i transportit i themeluar në territorin e një Pale Kontraktuese mes pikave për ngarkim dhe shkarkim të vendosura në territorin e Palës tjetër Kontraktuese."

### Neni 3

Neni 10 "Dispozitat tatimore" ndryshohet si në vijim:

"1. Karburanti në rezervuarët normal të automjetit, të cilët janë ndërtuar nga prodhuesi dhe janë të destinuar për ngasjen e automjetit dhe funksionimin e mjetit motorik, si dhe vajrat përjashtohen nga të gjitha taksat e importit në territorin e vendit nikoqir.

2. Transporti i mbuluar nga kjo marrëveshje i nënshtrohet në vendin nikoqir pagesave dhe detyrimeve tjera të vendosura për shfrytëzimin e rrjetit rrugor, tuneleve dhe urave."

E bërë në Sohne më 25 <sup>april</sup> 2016 në tri kopje në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze, ku të tri kopjet janë njëllorj autentike. Në rast të dallimeve në interpretim, versioni në gjuhën angleze do të mbizotëroj.

PËR QEVERINË E  
REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS

PËR QEVERINË E  
REPUBLIKËS SË  
BULLGARISË